



VENDIM

Nr. 35, datë 02.03.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT
PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË KOMBINUAR TË GAZIT
NATYROR TË ALBGAZ SH.A.**

Bazuar në nenet 13, 36, 37 dhe 80 të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Vendimit të Këshillit Ministerial nr.D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr.9501, datë 03.04.2006, nenet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 pika 3, të “Rregullave për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” të miratuar me Vendimin nr.100, Datë 05.08.2015 të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, me Vendimin nr.129, datë 31.10.2015 të Bordit të ERE-s, nenit 19 pika 1, gërma “b” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Bordit të ERE nr.96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 02.03.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi aplikimin për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të Albgaz Sh.a.

Duke konsideruar që:

- Shoqëria Albgaz Sh.a., me shkresën Nr. 166 prot, datë 20.02.2016, rregjistruar në ERE, ka paraqitur kërkesën për certifikimin në aktivitetin e operatorit të kombinuar të gazit natyror të Albgaz Sh.a.
- Kjo kërkesë për miratim, mbështetet në sa përcaktuar në nenin 37 dhe 80 të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullave për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror” të miratuar me Vendimin nr. 100, datë 05.08.2015 të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, si dhe VKM. Nr. 848, datë 07.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sha dhe “Albgaz” sha” e cila përcakton se : “Me regjistrimin në QKB, shoqëria “Albgaz” sh.a., të aplikojë pranë Entit Rregullator të Energjisë për certifikim, si

operator transmetimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe për pajisjen me licencë për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

- Për efekt të këtij aplikimi nga Albgazi sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentat e parashikuara në nenin 9 të "Rregullat për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror", miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 100, datë 05.08.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015
- Dokumentat, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas Nenit 9, të Rregullores janë paraqitur në ERE me shkrim dhe në mënyrë elektronike.
- ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar por mund të kërkojë nga Albgaz sh.a, çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit referuar Ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".
- ERE në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e sektorit të gazit natyror dhe në përputhje me Ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe të detyrimeve sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë ratifikuar me Ligjin Nr.9501, datë 03.04.2006, ka miratuar me vendimin nr. 100, datë 05.08.2015 dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015 "Rregullat për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror".
- Neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, dhe neni 38 i Ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", parashikon që ERE, duhet të vërë në dijeni Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin e operatorit të kombinuar të gazit natyror Albgaz Sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit t'i përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë,

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit t'i përcjellë këtë vendim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI